

# Shpresoj se Perëndimi nuk do të ndërvoj në Siri, sepse ndërvenimin e tillë e kam përjetuar personalisht <sup>1</sup>

<sup>1</sup> Përkthim i Fondit për të Drejtën Humanitare.

*Në vitin 1999, në Beograd rregullisht janë dëgjuar sirenat për rrezikun nga ajri, kurse ne kemi jetuar sipas instinktit, në frikë të vazhdueshme*

Askush nga miqtë e mi në Beograd nuk ka besuar se Perëndimi njëmend do të na bombardoj. E kanë përjetuar vetveten si qytetarë modern të një metropole evropiane, por babai im nuk ka menduar ashtu. Ka qenë veteran i Luftës së Dytë Botërore dhe tashmë e kishte përjetuar strehimin masiv të ushqimit, benzinës dhe barërave. Sot, derisa mendoj mbi Damaskun, e pyes vetveten se çfarë mendojnë qytetarët e tij mbi ndërvenimin e Perëndimit. Do të mund t'iu rrëfeja atyre diçka lidhur me këtë.

Në datën 24 mars janë dëgjuar sirenat e para. Ka mbizotëruar instinkti dhe të gjithë kemi ikur në bodrume. I kemi marrë me vete konservat e ushqimit, sepse këtë e kemi parë në filma. Pasi që kemi jetuar në qendër të qytetit asokohe bodrumet ishin të mbushura plot dhe, së këndejmi, të gjithë banorët kanë shkuar te një fqinje jona, Mica. Mica ka qenë me kombësi rome dhe jetonte nga lypësia dhe prostitucioni. Kur kemi arritur deri te shtëpia e saj modeste, ajo na ka pritur me krenari me një shishe të rakisë së fortë të shtëpisë, si një nikoqire e vërtetë. Rreziku jetësor, në të cilin jemi gjendur, i kishte fshirë të gjitha ndryshimet midis nesh – para tij të gjithë kemi qenë të barabartë. Nuk kemi menduar për kurrfarë letrash dhe vlerat shoqërore dhe jemi përpjekur që disi ta pushtojmë frikën në vetvete. Me kalimin e kohës, sirenat kanë qenë gjithnjë e më të shpeshta dhe më të shumta. Patëm filluar të jetojmë si nën rrethim. Në pauzat midis alarmeve kemi bërë lëvizje në drejtim të kërkimit të ushqimit, cigareve, pijeve dhe barërave. Të gjitha shitoret kanë qenë të zbrazura dhe të mbyllura dhe ka lulëzuar tregtia e rrugës. Hiper-inflacioni e kishte rrëzuar vlerën e parasë, bankat dhe shkollat kanë qenë të mbyllura, transporti publik nuk ka punuar, kurse në automobilat tanë nuk ka pasur benzinë. I tërë qyteti ishte shndërruar në një treg të madh të zi.

Deri atëherë nuk kam qenë e ndërgjegjshme se fqinjët e mi janë njerëz ashtu të butë e të sjellshëm, gjithnjë të gatshëm t'iu ndihmojnë njëri-tjetrit. Dyert e mia kanë qenë të hapura për të gjithë dhe e tërë banesa së shpejti ka qenë shndërruar në një klinikë të improvizuar për të gjithë ata të cilët kanë qenë të frikësuar ose nuk kanë mundur për të fjetur. Në atë periudhë spitalet dhe institucionet e përkujdesjes mendore i kishin lëshuar të gjithë pacientët e vet dhe, së këndejmi, para dyerve të mia patën filluar të paraqiten njerëz të ndryshëm me neuroza dhe probleme të tjera shpirtërore, por edhe një numër i madh i të pastrehëve, të cilët nuk kishin ku të strehoheshin. I kanë sjellë me vete thasët e gjumit e, ndonjëherë, edhe ushqimin dhe pijet, nëse i kanë pasur.

I kemi kaluar netët duke i vëzhguar aeroplanët e NATO-s. Shpejt jemi mësuar për ta vlerësuar largësinë e eksplozimit në bazë të fuqisë së dridhjes dhe kemi shpikur mënyra të ndryshme për të ditur se çfarë ishte duke ndodhur me miqtë dhe me të afërmit tanë në pjesët e bombarduara të qytetit. Telefonat kryesisht nuk kanë punuar, kurse shpesh nuk kishte as furnizim me rrymë e as ujë. Por, njerëzit kanë lëvizur në qytet në këmbë ose me biçikleta dhe, në këtë mënyrë, i kanë përcjellë lajmet thuajse janë farë korrierë. Fëmijët kanë qenë më të mirët në këtë drejtim, ata kanë qenë bërë postierët tanë të ri plot energji dhe kureshtje. Nuk e ndjenin frikën dhe tmerrin, që ne, si të rritur, vazhdimisht jemi përpjekur për ta fshehur prej tyre.

Më kujtohet në i ri, i cili kishte ardhur me biçikletë për ta këmbyer tortën e nënës së tij për një libër të Hannah Arendtit, të cilën e kam përkthyer. Kishte bërë një dush në banesën time pasi që ne ende kishim ujë e pastaj ka shkuar në shtëpi për të dërguar disa e-maila të mitë, sepse në pjesën ku ai jetonte ende kishte rrymë elektrike. Kështu dukej përditshmëria jonë – jetët tona ishin reduktuar në një pjesë të qytetit në të cilën kishim jetuar. Kemi pasur tejet pak informacione mbi gjithë atë që ngjante në

vendet e tjera dhe nuk besonim në rrjedhën pozitive të gjithë asaj historie. Por kemi pasur mjaft dinjitet dhe e kemi dashur njëri-tjetrin. Gjatë atyre ditëve, të cilat për shumë kë kanë qenë të fundit, lidhjet dashurore ose, madje, edhe martesat – kanë qenë një dukuri shumë e shpeshtë.

Në mënyrë që koha të kalonte sa më shpejt gjatë bombardimeve, e kam bërë një film dhe e kam botuar ditarin tim të luftës në internet. Së shpejti jam miqësuar me kronist të tjerë të shumtë të luftës, siç është Nuha-e al-Radi, disidente dhe emigrante irakiane, e cila gjatë luftës qytetare të Libanit e ka përjetuar bombardimin e Bejrutit. E-Ditari im ka shkaktuar reaksione edhe në disa pjesë të tjera të botës e, madje, e ka botuar edhe *Guardian-i*. Një mik i vjetër i babait tim nga fakulteti (i cili aso kohe jetonte në Mançester) më ka thënë se nga ai artikull – për habinë dhe gëzimin e tij të madh – ka kuptuar se jemi gjallë e shëndosh. Interneti, në të vërtetë, na ka ndihmuar të ndjehemi më pak të izoluar.

Njerëzit e Beogradit e kanë mbijetuar bombardimin e NATO-s, por shumë prej tyre pas intervenimit kanë vdekur nga pasojat e shkatërrimit të luftës. Arsyet kanë qenë të numërta - stresi post-traumatik , pluhuri nga uraniami i varfëruar, sistemi i shkatërruar i kujdesit shëndetësor. Edhe nëna ime ka qenë një nga ata. Vendet fqinje, po ashtu, i kanë vuajtur pasojat e ajrit dhe të ujit të ndotur, por edhe efektet e sanksioneve ekonomike paralizuese, të cilat e kanë përfshirë tërë zonën e luftës. Pasojë përfundimtare e gjithë konfliktit në të vërtetë ka qenë globalizimi i Ballkanizimit - secili, në secilin vend dhe në secilin moment, ka mundur të jetë i vrarë; vështruar nga këndi humanitar, të paktë janë ata të cilët nga e gjithë kjo do të kenë farë dobie.